

OZhQ-të përballë fushëveprimtarisë dhe misionit të komunave të Kosovës



11



Autor: INDEP

Programi: Zhvillim i Qëndrueshëm

Publikuar: Tetor, 2022

Dizajni: KUKU Creative



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, përfaqësojnë opinionin e autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Përmbajtje

Hyrje.....	4
Synimet e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm relevante për komunitetet e Republikës së Kosovës	4
Korniza legjislative dhe e politikave.....	20
Raportimi	22
Përfundime	23

Hyrje

Ndonëse Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm mund të duken si përgjegjësi e nivelit nacional, edhe pushteti lokal ka rol të rëndësishëm në përmbushjen e tyre. Në fakt, "qeveritë lokale janë politikë-bërës, katalizatorë të ndryshimit dhe të pozicionuar më së miri për të ndërlidhur qëllimet globale me komunitetet lokale.¹

Në tërësi, rreth 60% e zbatimit të OZHQ-ve bie mbi barrën e pushtetit lokal. Nga 169 Synime (Targete) të definuara, janë 99 prej tyre relevante për komunat e Kosovës. Një pjesë e konsiderueshme e Synimeve janë të hartuara me një gjuhë të përgjithësuar dhe krijojnë hapsirë për interpretim, mirëpo shumica dërmuese janë të zbatueshme nga komunat.

OZHQ-të ndërlidhen me shumë sfera të punëve ditore të komunave siç janë ofrimi i shërbimeve publike, sigurimi i banimit adekuat dhe të përbalueshëm, ruajtja e mjedisit dhe reduktimi i mbeturinave, promovimi i bujqësisë dhe ekonomisë lokale, e të tjera.


Në aspektin vendor, komunat e Republikës së Kosovës përmes aktiviteteve të përditshme zbatojnë një numër të konsiderueshëm të Synimeve të parapara për përmbushje të OZHQ-ve. Ajo që mungon është procesi i lokalizimit të OZHQ-ve në politika komunale si dhe monitorimi dhe raportimi rreth përmbushjes së tyre. Vetëm disa komuna, me përkrahje të Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) është bërë lokalizimi i OZHQ-ve.

Sa i përket monitorimit dhe raportimit, vetëm një komunë deri tash ka marrë iniciativën e hartimit të Rishikimit Lokal Vullnetar, i cili është mekanizëm i miratuar nga Kombet e Bashkuara për të raportuar në mënyrë vullnetare rreth përmbushjes së OZHQ-ve. Shumica e komunave në Kosovë mund të jenë ende në fazë të hershme për të iniciuar procesin e Rishikimit Lokal Vullnetar, pasi ende nuk kanë bërë lokalizimin. Mirëpo, komunat mund të fillojnë një proces të lehtë të ndërlidhjes së strategjive dhe planeve lokale me OZHQ-të dhe të bëjnë raportim të aktiviteteve drejt përmbushjes së tyre përmes përfshirjes së Synimeve të OZHQ-ve në punën e tyre.

Ky raport bën identifikimin e Synimeve të OZHQ-ve të cilat janë relevante për pushtetin lokal si dhe një shqyrtim të legjislacionit dhe politikave bazë që rregullojnë pushtetin lokal. Po ashtu, bën ndërlidhjen e kompetencave bazë komunale me OZHQ-të përkatëse. Gjithashtu, raporti ofron shembuj të përfshirjes së Synimeve në punën e drejtorive komunale.

Synimet e Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm relevante për komunat e Republikës së Kosovës

Siç është potencuar në hyrje, komunat janë përgjegjëse për përmbushjen e afërsisht 65% të OZHQ-ve dhe Synimeve përkatëse. Nga gjithësej 169 Synime, 99 prej tyre bien nën kompetencë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë të komunave. Më poshtë janë selektuar vetëm Synimet që bien nën përgjegjësi të komunave.

	Objektivi 1. Eliminimi i të gjitha formave të varfërisë
1.1 Deri në vitin 2030, të zhduket varfëria ekstreme për të gjithë njerëzit kudo, e matur aktualisht me numrin e njerëzve që jetojnë sot me më pak se 1.25 \$ në ditë.	

¹ Shih [në gjuhën angleze]:

file:///C:/Users/Buton/Desktop/SDG%20Synims%20for%20Local%20Government/the_sdgs_what_localgov_need_to_know_0.pdf

1.2 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet të paktën përgjysëm përqindja e burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave, që jetojnë në varfëri, në të gjitha dimensionet e saj, në bazë të përcaktimeve kombëtare.

1.3 Të zbatohen sistemet dhe masat e përshtatshme kombëtare të mbrojtjes sociale për të gjithë, përfshirë dhe shtresat e ulëta, dhe deri në vitin 2030 të arrihet një mbulim i konsiderueshëm i njerëzve të varfër dhe të pambrojtur.

1.4 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë burrat dhe gratë, në veçanti njerëzit e varfër dhe të pambrojtur, të kenë të drejta të barabarta në përdorimin e burimeve ekonomike, si qasje në shërbimet minimale, pronësi dhe kontroll mbi tokën, si dhe në forma të tjera të pronësisë, të trashëgimisë, të burimeve natyrore, të teknologjive të reja të përshtatshme dhe të shërbimeve financiare, përfshirë dhe mikrofinancat.

1.5 Deri në vitin 2030, të rriten aftësitë për të përballuar situatat e pafavorshme prej të varfërve dhe të atyre që jetojnë në gjendje të vështirë dhe të zvogëlohet ekspozimi dhe cënueshmëria e tyre ndaj ngjarjeve ekstreme të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë e tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore.

1.a Të sigurohet përdorimi i plotë i burimeve të ndryshme, edhe përmes një bashkëpunimi më të fortë për zhvillim, në mënyrë që të sigurohen mjetet e duhura dhe të parashikueshme për vendet në zhvillim, e në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, për të zbatuar programe dhe politika me qëllim dhënien fund varfërisë në të gjitha dimensionet e saj.

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Krijimi i një liste të familjeve që jetojnë në varfëri brenda komunës. Po ashtu mund të hulumtohen edhe shkaqet që qojnë në varfëri qofshin ato ekonomike, sociale apo mjekësore. Në bazë të këtyre të dhënave mund të hartohen plane për trajtimin e problemit.
2. Ofrimi i strehimit për familjet e varfëra. Kjo mund të realizohet përmes mjeteve komunale apo edhe përmes donatorëve. Komuna mund të bëjë koordinimin me donatorët potencial për të ofruar informata rreth familjeve më në nevojë për strehim.
3. Dhënia e ndihmave përmes skemave sociale. Komuna mund të shpërndajë ndihmat dhe donacionet tjera në bazë të listës së saktë të identifikuar nën pikën 1.
4. Miratimi i masave që ndihmojnë në reduktimin e kostos së jetës për familjet e varfëra. Këto përfshijnë: lirimi nga pagesa e obligimeve të shërbimeve komunale, shërbimet e transportit urban, përkrahja në uljen e kostos së energjisë përmes dhënies së donacioneve të energjisë së ripërtitërshe siç janë panelet solare, lehtësira në lëshimin e pëlqimeve komunale për panele solare etj.
5. Raportimi i numrit të familjeve të strehuara dhe të ndihmuara. Është esenciale për komunat të kenë informata të sakta rreth numrit të familjeve të varfëra të cilave iu është ndërtuar shtëpi nga fondet komunale apo nga donatorët apo që janë strehuar përmes skemave të qiradhënies. Në këtë mënyrë përditësohet lista e familjeve që kanë zgjidhur çështjen e banimit dhe raportohet rreth shkallës së përmbushjes së këtij Objektiv të Zhvillimit të Qëndrueshëm.



Objektivi 2. Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe e përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme

2.1 Deri në vitin 2030, të eliminohet uria dhe të sigurohet e drejta e të gjithë njerëzve, në veçanti e të varfërve dhe e atyre që jetojnë në gjendje të vështirë, përfshirë foshnjat, për të patur ushqim të sigurt dhe të mjaftueshëm përgjatë gjithë vitit.

2.2 Deri në vitin 2030, të eliminohen të gjitha format e kequshqyerjes, përfshirë edhe arritjen, deri në 2025-ën, të treguesve të miratuar ndërkombëtarisht lidhur me frenimin e zhvillimit të fëmijëve nën 5 vjeç dhe të adresohen nevojat për ushqim të vajzave adoleshente, të grave shtatzëna dhe atyre që ushqejnë foshnjat me gji, si dhe të personave të moshuar.

2.3 Deri në vitin 2030, të dyfishohet prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve ushqimorë në shkallë të vogël, veçanërisht e grave, popujve indigjenë, familjeve fermere, blegtorëve dhe peshkatarëve, përfshirë edhe përmes qasjes së sigurt dhe të barabartë tek toka, burimet e tjera prodhuese, njohuritë, shërbimet financiare, tregjet dhe mundësitë për shtimin e vlerës dhe punësimin jashtë sektorit bujqësor.

2.4 Deri në vitin 2030, të sigurohen sisteme të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe të zbatohen praktika ripërtëritëse bujqësore që rrisin rendimentin dhe prodhimin, ndihmojnë në ruajtjen e ekosistemeve, forcojnë kapacitetin për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, motit ekstrem, thatësirave, përmytjeve dhe fatkeqësive të tjera dhe që në mënyrë progresive përmirësojnë cilësinë e tokës bujqësore.

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Dhënia në shfrytëzim e tokave në pronësi komunale për familjet e varfëra me qëllim të kultivimit të produkteve ushqimore. Përmes kësaj mase, familjet e varfëra mund të marrin përkohësisht në shfrytëzim një parcelë të caktuar nga komuna, për të mbjellur ushqime të domosdoshme për mbijetesë.
2. Bashkëpunimi me kompani prodhuese të ushqimit dhe gastronomi. Komuna mund të krijojë një rrjet me kompani prodhuese për shpërndarjen e një pjese të ushqimit të prodhuar si përgjegjësi sociale. Gjithashtu, me gastronomi mund të organizohet mbledhja e ushqimit të mbetur të pakonsumuar dhe të pashitur për t'u shpërndarë familjeve të varfëra.
3. Hapja dhe rritja e numrit të kuzhinave publike. Komunat të cilat kanë kuzhina publike falas mund të rrisin numrin në zonat të cilat ka numër më të madh të familjeve të varfëra. Po ashtu, komunat të cilat nuk aplikojnë një praktikë të tillë, mund të inicojnë kuzhinat e tilla për familjet e varfëra.
4. Ofrimi i granteve për start-up biznese për bujqësi. Kjo është një praktikë në shumë komuna, por për adresim më të mirë të problematikës, kriteret e dhënies së granteve mund të targetojnë familjet e varfëra.
5. Fushata vetëdijësuese për ushqim të shëndetshëm dhe të sigurt dhe kundër hedhjes së ushqimit. Komuna duhet të organizojë fushata për të informuar qytetarët rreth rreziqeve nga ushqimet e pashëndetshme. Po ashtu, duhet të ngritë vetëdijen e qytetarëve për konsum të përgjegjshëm dhe të moderuar.
6. Komuna mund të rrisë sipërfaqet e tokave të kyçura në sistem të integruar të ujitjes.



Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe

3.1 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet raporti global i vdekshmërisë së nënave në më pak se 70 vdekje për 100,000 lindje.

3.2 Deri në vitin 2030, të parandalohen vdekjet e të posalindurve dhe e fëmijëve nën moshën 5 vjeç, ku të gjitha vendet të synojnë zvogëlimin e vdekshmërisë të të posalindurve në më pak se 12 vdekje për 1,000 lindje dhe të vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç në më pak se 25 vdekje për 1,000 lindje.

3.3 Deri në vitin 2030, të eliminohen epidemitë e SIDA-s, të tuberkulozit, të malaries dhe të sëmundjeve tropikale të neglizhuara dhe të luftohet hepatiti, sëmundjet që transportohen përmes ujit dhe sëmundjet e tjera ngjitëse.

3.4 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet me një të tretën vdekshmëria tek lindjet e parakohshme si pasojë e sëmundjeve jo të transmetueshme, përmes parandalimit dhe trajtimit dhe promovimit të shëndetit mendor dhe të mirëqenies.

3.5 Të forcohet parandalimi dhe trajtimi i personave që abuzojnë me lëndët narkotike dhe alkoolin.

3.6 Deri në vitin 2030, të përgjysmohet numri global i vdekjeve dhe i lëndimeve nga aksidentet rrugore.

3.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasja e gjithanshme në shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues, përfshirë dhe planifikimin familjar, informimin dhe edukimin, dhe futjen e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare.

3.9 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet dukshëm numri i vdekjeve dhe i sëmundjeve nga kimikatet e rrezikshme dhe nga ndotja e ajrit, e ujit dhe e tokës.

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Promovimi i stilit të jetës së shëndetshme. Komuna mund të bëjë fushata për rritjen e vetëdijes së qytetarëve rreth benefiteve nga një stil i jetës së shëndetshme. Po ashtu, mund të krijojë kushte përmes një kombinimi të masave infrastrukturore dhe mjedisore. Këtu mund të përfshihen edhe masat vetëdijësuse kundër përdorimit të lëndëve narkotike, alkoolit e duhanit.
2. Ofrimi i kontrolimeve mjekësore falas dhe mobile për gratë shtatëzëna dhe për fëmijët e posalindur. Kjo masë mund të ndikojë drejtpërdrejtë në adresimin e targeteve 3.1 dhe 3.2. Në veçanti ofrimi i shërbimit mobil nëpër zona më të largëta rurale mund të shpëtojë jetën e nënave dhe të posalindurve.
3. Masat për zvogëlimin e aksidenteve në komunikacion. Në bashkëpunim me nivelin qendror, komuna mund të identifikojë *pikat e zeza* në komunikacion (blackspots) ku ndodhin aksidente të shpeshta, dhe të ndër marrë masa përkatëse për të reduktuar aksidentet në këto pika. Gjithashtu kjo duhet të shoqërohet me aktivitete të ndërgjegjësimit të qytetarëve për vozitje të kujdeshme dhe të sigurt në përputhje me rregullat e komunikacionit.


4. Ndërtimi i zonave të shumta për sporte dhe aktivitete rekreative. Krijimi i kushteve për aktivitete sportive dhe edukative do të ishte një stimulim shtesë për qytetarët të bëjnë një jetë më të shëndetshme. Këto zona do të shoqëroheshin me hapsira gjelbëruese që do të kishin ndikim pozitiv në mjedis dhe shëndet.
5. Qasje proaktive për rritjen e shkallës dhe gamës së vaksinimit. Në bashkëpunim me nivelin qendror të bëhen plane për arritjen e vaksinimit në shkallë më të madhe. Në veçanti duhet të synohet zgjerimi i programit të vaksinimit me vakcina kundër HPV-së, meningjitit, e të tjera.

	<p>Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe nxitja e mundësive për edukim gjatë gjithë jetës për të gjithë</p>
<p>4.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsimimin fillor dhe 9 vjeçar pa pagesë, të barabartë dhe cilësor, që çon në rezultate të rëndësishme dhe efikase të të mësuarit.</p> <p>4.2 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë vajzat dhe djemtë kanë të drejtë për zhvillim cilësor që në fëmijërinë e hershme, për përkujdesje dhe për edukim para-shkollor, në mënyrë që të jenë gati për arsimim fillor.</p> <p>4.3 Deri në vitin 2030, të sigurohen qasje të barabartë për të gjithë gratë dhe burrat që të ndjekin arsimin profesional, teknik apo atë universitar me kosto të përballeshme dhe cilësor.</p> <p>4.4 Deri në vitin 2030, të sigurohet rritje e ndjeshme e numrit të të rinjve dhe të të rriturve që kanë aftësitë e nevojshme, përfshirë aftësitë teknike dhe ato profesionale, për t'u punësuar, për punë cilësore dhe sipërmarrje.</p> <p>4.5 Deri në vitin 2030, të eleminohet pabarazia gjinore në arsim dhe të sigurohet qasje e barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe të trajnimit profesional për grupet më të ndjeshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, popujt indigjenë dhe fëmijët e pambrojtur.</p> <p>4.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë nxënësit të marrin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar Zhvillimin e Qëndrueshëm, përfshirë, ndër të tjera, Edukimin për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe një mënyrë jetese të qëndrueshme, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, përkrahjen e kulturës së paqes dhe jo të dhunës, qytetarinë globale dhe vlerësimin ndaj shumëllojshmërisë së kulturave dhe të kontributit që jep kultura për Zhvillimin e Qëndrueshëm.</p> <p>4.a Të ndërtohen dhe të përmirësohen objektet arsimore të përshtatshme për fëmijët, për personat me aftësi të kufizuara dhe për ndjeshmërinë gjinore dhe të sigurohen mjedise të sigurta, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe efektive në të mësuar për të gjithë.</p>	

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:


1. Arsimimi gjithëpërfshirës dhe padiskriminim. Komunat mund të ndërmarrin hapa për të siguruar barazi në arsimim. Në veçanti duhet të sigurohet integrim në baza gjinore dhe të shmangët segregacioni. Po ashtu, është e rëndësishë madhore që fëmijët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta të përfshihen në mësim të rregullt. Punësimi i asistentëve për këta fëmijë do të ndihmonte shumë që këta fëmijë të zënë progresin me fëmijët tjerë dhe do të lehtësonte punën për arsimtarët.

2. Organizimi i aktiviteteve për zhvillim të qëndrueshëm. Komunitat mund të promovojnë aktivitete dhe vizita për nxënës për të rritur vetëdijen e tyre rreth jetës së shëndetshme, mbrojtjes së mjedisit, inovacionit, kultivimit të ushqimit organik, e të tjera.
3. Identifikimi i kërkesës së tregut për punësim. Në bashkëpunim me nivelin qendror, të profilizohen shkollat profesionale për të përmbushur kërkesat e tregut në komunitet përkatës. Kurrikulat e shkollave profesionale me kërkesë të komuniteteve mund të adaptohen për t'u përshtatur kërkesat të tregut të punës të një komune apo rajoni.
4. Të gjitha shkollat të kenë qasje për persona me aftësi të kufizuara. Pjesa më e madhe e shkollave kanë ndërtuar pjerrinat që mundësojnë hyrjen në shkollë të nxënësve dhe qytetarëve tjerë me aftësi të kufizuara. Por në shumicën dërmuese të shkollave, personat me aftësi të kufizuara nuk kanë qasje në katet e sipërme të shkollave sepse mungojnë ashensorët. Prandaj, komunitat duhet të sigurojnë që shkollat e reja që ndërtohen të kenë edhe ashensor, dhe të fillojnë një program të instalimit të ashensorëve në shkollat ekzistuese.
5. Ndërtimi i infrastrukturës sportive dhe pajisja me instrumente muzikore. Të gjitha shkollat duhet të bëjnë prioritet ndërtimin e infrastrukturës së jashtme dhe të brendshme sportive për të krijuar praktikën e jetës sportive dhe të shëndetshme për nxënësit. Po ashtu, komunitat duhet të ofrojnë edhe kushte për zhvillim kulturor, në veçanti muzikor për nxënësit. Komunitat mund të organizojnë gara në të gjitha sportet për të rritur frymën sportive dhe konkurruese, si dhe koncerte muzikore.

	<p>Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave</p>
<p>5.1 T'i jepet fund kudo të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave.</p> <p>5.2 Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit.</p> <p>5.3 Të eliminohen të gjitha praktikatat e dëmshme siç janë martesat e fëmijëve, martesat në moshë të hershme dhe martesat e detyruar dhe gjymtimi gjeneral femëror.</p> <p>5.4 Të njihet dhe të vlerësohet kujdesi dhe puna shtëpiake pa pagesë, përmes dhënies së shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave të mbrojtjes sociale dhe përkrahjes së përgjegjësisë të përbashkëta brenda shtëpisë dhe familjes, në përputhje me praktikatat kombëtare.</p> <p>5.5 Të sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe efektive e grave dhe dhënia e mundësive të barabarta për udhëheqjen e tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike.</p> <p>5.6 Të sigurohet qasja e gjithanshme në shëndetin seksual dhe atë riprodhues dhe në të drejtat riprodhuese, siç është rënë dakord, në përputhje me Programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe me Platformën për Veprim të Pekinit dhe dokumentet e tjera rezultat i konferencave të zhvilluara.</p> <p>5.a Të ndërmerren reforma për t'i dhënë grave të drejta të barabarta mbi burimet ekonomike dhe të drejta pronësie dhe kontrolli mbi tokën dhe forma të tjera të pronësisë, të shërbimeve financiare, të trashëgimisë dhe burimeve natyrore, në përputhje me ligjet kombëtare.</p> <p>5.c Të miratohen dhe të forcohen politikatat e shëndosha dhe legjislativi i zbatueshëm në përkrahjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet.</p>	

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:


1. Komuna të miratojnë dhe zbatojnë politika dhe plane të veprimit për të siguruar barazi gjinore në punën e të gjitha departamenteve. Po ashtu, komuna duhet të miratojnë të gjitha rregulloret e brendshme të cilat sigurojnë barazi të plotë gjinore, luftojnë diskriminimin gjinor dhe dhunën psikologjike/emocionale ndaj grave. Këto rregullore duhet të sigurojnë barazi gjinore në pozita vendimmarrëse në komunë dhe organe komunale dhe parashohin sanksione proporcionale për shkeljet përkatëse.
2. Promovimi i pavarësisë ekonomike të grave dhe ndërmarrësisë. Komuna duhet të prioritetizojë përmes rritjes së numrit të granteve mbështetëse për gratë ndërmarrëse. Po ashtu, lansimi i programeve për zhvillimin e shkathtësive për gratë.
3. Bashkëpunimi proaktiv me nivelin qendror, Policinë e Kosovës dhe organizata joqeveritare e donatorë për të adresuar dhunën familjare, ofrimin e strehimit dhe dukuritë tjera negative.
4. Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje. Të sigurohet që gratë, në veçanti ato në jetojnë në zona rurale të konsultohen gjatë hartimit të planeve dhe buxheteve komunale për të marrë parasysh kërkesat e tyre.
5. Komuna të inicojnë programe që lehtësojnë kujdesin prindëror, posaqërisht në rastet e nënave vetushqyese.

	Sigurimi i furnizimit dhe i menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë
<p>6.1 Deri në vitin 2030, të arrihet furnizimi i gjithanshëm dhe i barabartë me ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë;</p> <p>6.2 Deri në vitin 2030, të mundësohet qasje në sistemin e kanalizimeve dhe të higjienës të përshtatshme dhe të barabartë për të gjithë dhe t'i jepet fund jashtëqitjeve në hapësira të hapura, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe personave që janë në gjendje të pambrojtur.</p> <p>6.3 Deri në vitin 2030, të përmirësohet cilësia e ujit duke zvogëluar ndotjen, duke eliminuar hedhjen e mbetjeve jashtë vendit të përcaktuar dhe duke minimizuar shkarkimin e kimikateve dhe të materialeve të tjera të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e sasisë së ujërave të zeza të patrajtuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt në nivel global.</p> <p>6.4 Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm përdorimi efikas i ujit në të gjithë sektorët dhe të sigurohet tërheqja e qëndrueshme e tij dhe furnizimi me ujë të pijshëm për të adresuar mungesën e ujit dhe për të zvogëluar ndjeshëm numrin e njerëzve që vuajnë nga mungesa e ujit.</p> <p>6.5 Deri në vitin 2030, të zbatohet menaxhimi i integruar i burimeve ujore në të gjitha nivelet, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkufitar sipas rastit.</p> <p>6.6 Deri në vitin 2020, të mbrohen dhe të rigjenerohen ekosistemet ujore, përfshirë dhe malet, pyjet, luginat, lumenjtë, ujërat nëntokësore dhe liqenet.</p> <p>6.a Deri në vitin 2030, të zgjerohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetja për ngritjen e kapaciteteve në vendet në zhvillim lidhur me aktivitete dhe programe për ujin dhe kanalizimet, përfshirë dhe grumbullimin e ujit, shkripëzimin, eficiencën e përdorimit të ujit, trajtimin e ujërave të zeza, teknologjitë e riciklimit dhe të ripërdorimit.</p>	

6.b Të mbështetet dhe të forcohet pjesëmarrja e komuniteteve vendore në përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe të kanalizimeve.

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:


1. Bërja prioritet e shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimeve të të gjitha ekonomitë familjare. Në këtë mënyrë komuna e bën jetën më të lehtë për qytetarët dhe ofron kushte më të mira sanitare duke ulur mundësinë e përhapjes së sëmundjeve.
2. Kujdesi i shtuar për burimet nëntokësore, lumenjtë dhe liqenet artificiale. Komunat të monitorojnë rregullisht projektet zhvillimore dhe të biznesit të cilat mund të dëmtojnë potencialisht ujërat nëntokësore, lumenjtë ose liqenet. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtet ruajtjes së pastërtisë së këtyre ujërave për të siguruar jetë të shëndetshme të qytetarëve.
3. Rritja e vetëdijes për shpenzim të kujdesshëm të ujit. Komuna duhet të promovojë edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve që të harxhojnë ujin në mënyrë të kujdesshme, dhe të mos e shpenzojnë në mënyrë të panevojshme. Në veçanti, duhet të kontrollohet bizneset me konsum të lartë, dhe kopshtet e mëdha për të siguruar që kanë burim vetanak të vaditjes dhe nuk përdorin ujë të pijshëm për vaditje të kopshteve apo për qëllime të biznesit.
4. Krijimi i rezervave. Komunat duhet të shikojnë mundësinë e krijimit të rezervave të ujit për të aktivizuar këta në rast të mungesës së ujit.
5. Uji i pijshëm dhe toaletet në vende publike. Komunat të ofrojnë krua me ujë të pijshëm në parqe dhe vende publike të frekuentuara. Gjithashtu, duhet të ketë dhe tualete publike në këto zona.

	Sigurimi i lidhjes me energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë
<p>7.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e përgjithshme në shërbime të përballueshme, të besueshme dhe moderne të energjisë.</p> <p>7.2 Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm pjesa që zë energjia e rinovueshme në totalin e energjisë së përftuar nga burime të ndryshme në nivel global.</p> <p>7.3 Deri në vitin 2030, të dyfishohet norma globale e përmirësimit të eficiencës së energjisë.</p>	

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:


1. Bërja prioritet e solucioneve me energji të ripërtitërshe në të gjitha segmentet e punës së komunave.
2. Ofrimi i lehtësirave tatimore dhe obligimeve tjera komunale për ekonomitë familjare dhe bizneset që instalojnë konsumojnë burime të ripërtitërshe të energjisë. Përmes kësaj mase, komunat për shembull mund të lirojnë nga pagesa apo të ulin koston e lejeve ndërtimore, për kompanitë që ndërtojnë banesa kolektive, me kushtin e instalimit të paneleve solare si burim i qëndrueshëm dhe i padëmshëm ndaj mjedisit. Ngjashëm mund të vepohet edhe me lejët ndërtimore për shtëpitë individuale. Gjithashtu, lehtësime të ngjashme mund të aplikohen edhe për objektet ekzistuese duke i liruar/ulur tatimet komunale për një periudhë kohore pas instalimit të burimeve të tilla të energjisë.

3. Instalimi i burimeve të ripërtitërshe të energjisë nëpër të gjitha objektet komunale. Është esenciale që komunat, dhe të gjitha institucionet publike në tërësi, të shërbejnë si shembull duke instaluar burime energjie të qëndrueshme dhe miqësore ndaj mjedisit, siç janë panelet solare. Kjo masë do të kishte përfitime të shumëfishta për komunat dhe do të ishte shembull i mirë për t'u ndjekur nga qytetarët.
4. Informimi dhe ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i qytetarëve rreth benefiteve nga instalimi i burimeve të qëndrueshme dhe ripërtitërshe të energjisë. Komunat duhet të ndajnë një buxhet çdo vit për të promovuar këto masa të furnizimit me energji.
5. Ndërmarrja e masave për kursim të energjisë. Kjo mund të përfshijë subvencione për masat që kursejnë energjinë, siç është izolimi më i mirë i shtëpive dhe të ngjashme.
6. Ndërtimi i sistemeve të ngrohjes qendrore të bazuara në burime të ripërtrishme apo të tilla që sigurojnë efikasitet të lartë dhe rritje të kualitetit të jetës përmes qasjes në ngrohje qendrore.

	<p>Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë</p>
<p>8.3 Të përkrahen politika të orientuara në zhvillim, që mbështetin aktivitetet prodhuese, krijimin e vendeve të denja të punës, sipërmarrjen, krijimtarinë dhe risitë dhe të nxitet formalizmi dhe rritja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë edhe qasjes tek shërbimet financiare.</p> <p>8.4 Të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, deri në vitin 2030, eficientia e burimeve globale për konsum dhe prodhim dhe të synohet ndarja e rritjes ekonomike nga degradimi i mjedisit, në përputhje me kuadrin 10 vjeçar të programeve për konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm, ku vendet e zhvilluara marrin rolin udhëheqës në këtë proces.</p> <p>8.5 Deri në vitin 2030, të arrihet punësimi i plotë dhe produktiv dhe punë të denja për të gjithë gratë dhe burrat, përfshirë të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuar, si dhe pagesë të barabartë për punën me vlerë të njëjtë.</p> <p>8.6 Deri në vitin 2020, të zvogëlohet ndjeshëm përqindja e të rinjve të papunë, të paarsimuar apo të patrajnuar.</p> <p>8.7 Të merren masa të menjëhershme dhe efektive për të çrrënjësuar punën e detyruar, për t'i dhënë fund skllavërisë moderne dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe të sigurohet ndalimi dhe eliminimi i formave më të këqija të punës së fëmijëve, përfshirë rekrutimin dhe përdorimin e fëmijëve si ushtarë, dhe deri në vitin 2025 t'i jepet fund punës së fëmijëve në të gjitha format e saj.</p> <p>8.8 Të mbrohen të drejtat për punë dhe të mundësohen mjedise pune të sigurt për të gjithë punëtorët, përfshirë punëtorët emigrantë, e në veçanti gratë emigrante, dhe ata që punojnë në punë jo të sigurta.</p> <p>8.9 Deri në vitin 2030, të hartohen dhe të zbatohen politika për nxitjen e turizmit të qëndrueshëm, që krijon vende pune dhe përkrah kulturën dhe produktet vendase.</p>	

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Bashkëpunimi dhe dialogu i vazhdueshëm me ndërmarrësit dhe bizneset në komunë. Të ketë komunikim të sinqertë për të dëgjuar hallet dhe për të synuar përmbushjen e kërkesave të bizneseve. Po ashtu, të merren parasysh sygjerimet e bizneseve për kërkesën me punëtorë në tregun e punës, në mënyrë që komunat të bashkëpunojnë me nivel qendror për këtë qëllim.
2. Mbështetja e bizneseve për digjitalizim dhe inovacion dhe me subvencione të vazhdueshme për start up dhe biznese ekzistuese. Komuna të përcjellë trendet botërore të digjitalizimit dhe të inovacionit dhe të mbështet bizneset e tilla.
3. Promovimi i agroturizmit të qëndrueshëm. Komunat duhet të mbështesin zhvillimin e agroturizmit në Kosovë, në veçanti atë që themelohen dhe operojnë duke respektuar kriteret e qëndrueshmërisë.
4. Të hartohen plane për të adresuar problemin e fëmijëve lypës nëpër komunat përkatëse si dhe formave të rënda të punës për fëmijët.
5. Sigurimi i qasjes për persona me aftësi të kufizuara në vendet e punës. Komunat të sigurojnë që të gjitha ndërtesat publike dhe të biznesit të kenë qasje për persona me aftësi të kufizuara në të gjitha katet. Kjo do të lehtësonte punësimin e tyre.


	Ndërtimi i infrastrukturës rezistente, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit
<p>9.1 Të zhvillohet një infrastrukturë cilësore, e sigurt, e qëndrueshme dhe rezistente, përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e njerëzve, me fokus qasjen e përballueshme dhe të barabartë për të gjithë.</p> <p>9.2 Të përkrahet industrializimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm dhe, deri në vitin 2030, të rritet në mënyrë të konsiderueshme pjesa e industrisë së punësimit dhe e prodhimit të brendshëm bruto, në përputhje me kushtet e vendit dhe të dyfishohet kontributi i këtij sektori në vendet më pak të zhvilluara.</p> <p>9.3 Të rritet qasja e ndërmarrjeve të vogla industriale dhe e ndërmarrjeve të tjera, në veçanti në vendet në zhvillim, tek shërbimet financiare, duke përfshirë kredi të përballueshme, dhe integrimi i tyre në zinxhirët e vlerave dhe të tregjeve.</p> <p>9.c Të rritet në mënyrë të konsiderueshme qasje në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit dhe përpjekjet për të siguruar një qasje të gjithanshme dhe të përballueshme në internet në vendet më pak të zhvilluara, deri në vitin 2020.</p>	

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Komuna të sigurojë infrastrukturë të sigurt, të qëndrueshme dhe cilësore. Të caktohen standarde të larta të ndërtimit të infrastrukturës publike, banesave, etj. Vëmendje duhet t'i kushtohet që ndërtesat të jenë të qasshme për persona me aftësi të kufizuara në të katet e ndërtimit.
2. Të promovohet ndërtimi i qëndrueshëm. Komuna të vendos kërkesa për aplikim të materialeve që i plotësojnë standardet mjedisore dhe shëndetësore.
3. Nxitja e ekonomisë qarkore. Komuna të mbajë bashkëpunim të ngushtë me bizneset dhe të nxis bizneset që të aplikojnë konceptin e ekonomisë qarkore, p.sh. riciklimin e

materialeve/mbetjeve, furnizimin me energji të ripërtitërshe, shfrytëzimin e kujdesshëm dhe përgjegjshëm të burimeve ujore, ruajtjen e vlerave dhe traditave shoqërore, etj.

4. Solucione të komunikacionit për mobilitet efektiv. Të ofrohen solucione për fytat e ngushtë në komunikacion, promovimin e blerjen së veturave elektrike dhe hibride, rregullim të komunikacionit për të reduktuar ngarkesat në kohët më të ngarkuara.
5. Ofrimin e lehtësirave tatimore dhe hapsinore për industri të qëndrueshme. Komuna mund të nxis ndërtimin e fabrikave të qëndrueshme dhe miqësore për mjedisin duke dhënë tokën në shfrytëzim, duke liruar kompanitë nga ngarkesat tatimore dhe licencuese, etj.

	Zvogëlimi i pabarazisë brenda çdo vendi dhe ndërmjet shteteve
<p>10.1 Deri në vitin 2030, të arrihet në mënyrë progresive dhe të ruhet ritmi i rritjes të të ardhurave për 40 % të shtresës më të varfër të popullsisë me një ritëm më të lartë se ritmi i mesatares kombëtare.</p> <p>10.2 Deri në vitin 2030, të fuqizohet dhe të përkrahet përfshirja sociale, ekonomike dhe politike e të gjithë njerëzve, pavarësisht moshës, gjinisë, paaftësisë, racës, kombësisë, origjinës, besimit apo gjendjes ekonomike apo ndonjë statusi tjetër social.</p> <p>10.3 Të sigurohen mundësi të barabarta dhe të zvogëlohen pabarazitë e rezultateve, përfshirë përmes eliminimit të ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimit në këtë drejtim të legjisllacionit, politikave dhe veprimeve të përshtatshme.</p> <p>10.4 Të miratohen politika, sidomos ato fiskale, politika të pagave dhe të mbrojtjes sociale, dhe të arrihet në mënyrë progresive barazi më e madhe.</p> <p>10.7 Të lehtësohet migracioni dhe lëvizja e njerëzve e organizuar, e sigurt, e rregullt dhe e përgjegjshme, përfshirë edhe përmes zbatimit të politikave të planifikuara dhe të mirëmenaxhuara për migrimin.</p>	

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Partneriteti me organizata joqeveritare e donatorë për të ofruar kujdes, integrim dhe riintegrim të grupeve të cenuara.
2. Eliminimi i plotë i diskriminimit dhe segregacionit në arsim. Të miratohen sanksione të ashpra për shkollat, arsimtarët dhe nxënësit që bëjnë diskriminim, bullizëm apo që ushtrojnë dukuri tjera negative.
3. Qasje proaktive për rritur pjesëmarrjen e rinisë, pakicave dhe grupeve të cenuara. Komuna të ndërmerr hapa aktiv dhe të vazhdueshëm për të organizuar konsultime publike dhe forma tjera të përfshirjes së grupeve të ndryshme të qytetarëve në politikë-bërje. Në veçanti, të bëhen vizita në zonat e largëta rurale.
4. Shpërndarje e drejtë e buxhetit. Të sigurohet shpërndarje e drejtë e buxhetit duke shmangur diskriminimin në baza politike, etnike, apo tjera. Shpërndarja e padrejtë e buxhetit konsiderohet si cenim i drejtpërdrejt i barazisë dhe të drejtave të njeriut.
5. Promovimi i kohezionit social. Të sigurohet kohezioni shoqëror duke shmangur krijimin e zonave që mund të ndahen në bazë të një grupacioni shoqëror. Kjo mund të realizohet përmes politikave gjithëpërfshirëse të banimit, planifikimit hapsinor, integritit dhe diversitetit kulturor, etj.



Ndërtimi i qyteteve dhe i vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të sigurta, reziliente dhe të qëndrueshme

11.1 Deri në vitin 2030, të sigurohet për të gjithë njerëzit qasje për strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përbalueshëm dhe në shërbime bazë dhe të përmirësohet situata në lagjet e varfëra.

11.2 Deri në vitin 2030, të sigurohet për të gjithë qasje në sistemet e transportit të sigurt, të përbalueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar sigurinë rrugore, sidomos duke zgjeruar shërbimin e transportit publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të personave në gjendje të pambrojtur, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.

11.3 Deri në vitin 2030, të zgjerohet urbanizimi në nivel gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe të forcohen kapacitetet për planifikimin dhe menaxhimin e vendbanimeve të qëndrueshme, përfshirëse dhe pjesëmarrëse, në të gjitha vendet.

11.4 Të forcohen përpjekjet për të mbrojtur dhe për të ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës.

11.5 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe numri i njerëzve të prekur nga fatkeqësitë dhe të ulen ndjeshëm humbjet ekonomike të drejtpërdrejta, lidhur me prodhimin e brendshëm bruto në nivel global, të shkaktuara nga fatkeqësitë, përfshirë dhe fatkeqësitë që lidhen me ujën, me fokus mbrojtjen e shtresave të varfëra dhe të njerëzve në gjendje të pambrojtur.

11.6 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndikimi negativ në mjedis i qyteteve për kokë banori, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera.

11.7 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e gjithëanshme në hapësirat publike të gjelbra, të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të arritshme, në veçanti për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

11.a Të mbështeten lidhjet pozitive ekonomike, sociale dhe mjedisore ndërmjet zonave urbane, ndër-urbane dhe rurale duke forcuar planifikimin për zhvillim në nivel kombëtar dhe rajonal.


11.b Deri në vitin 2020, të rritet ndjeshëm numri i qyteteve dhe i vendbanimeve, duke miratuar dhe zbatuar politika dhe plane të integruara drejt gjithëpërfshirjes, eficiencës së burimeve, marrjes së masa për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, aftësisë ripërtëritëse ndaj katastrofave, dhe të zhvillohet e të zbatohet, në përputhje me Kornizën Kuadër të Sendai-it për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore 2015-2030, menaxhimi holistik i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore në të gjitha nivelet.

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Zgjidhja e problemit të banimit të kategoritë sociale. Të ndërtohen banesa të banimit social ose të ofrohen programe të qiramarrjes për rastet sociale nëpër komuna. Komunat mund të shqyrtojnë mundësinë e marrjes së banesave për strehim social në vend të pagesave të lejeve ndërtimore për ndërtesa ose lagje të mëdha.
2. Ruajtja e jetësës në fshatra dhe vendbanime të shpopulluara. Komuna të bëjë investime përkatëse në infrastrukturë për të parandaluar migrimin nga fshatrat në qytete dhe për të


parandaluar shpopullimin e zonave të caktuara. Kjo mund të përfshijë ndërtimin e rrugëve, ujësjellës e kanalizim, shkolla, etj. duke krijuar kushte optimale për jeta në këto zona.

3. Promovimi i transportit publik përmes sistemit multimodal. Kjo nënkupton përmirësimin e transportit publik, krijimin e linjave dhe parkingjeve për biçiklist dhe mjete tjera të transportit elektrik.
4. Përmirësimi i ajrit në zona me komunikacion të ngarkuar. Komuna mund të shqyrtojë mundësinë e caktimit të zonave për kufizim të lirit të karbonit, duke vendosur tarifa variabile të parkingut varësisht nga zonat e frekuentuara, p.sh. në zonat ku ka komunikacion të ngarkuar të ketë kosto më të lartë të parkingut.
5. Zona të qasshme dhe të përbashkëta publike. Komunitat të rrisin zonat e përbashkëta si trotuarët, parqet, zonat rekreative, zonat kulturore dhe historike.

	Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit
<p>12.2 Deri në vitin 2030, të arrihet menaxhimi i qëndrueshëm dhe përdorimi eficient i burimeve natyrore.</p> <p>12.3 Deri në vitin 2030, të përgjysmohen mbetjet ushqimore për kokë banori në nivel global, për të arritur në nivelet e shitjes me pakicë dhe të konsumatorit dhe të zvogëlohen humbjet e ushqimit përgjatë zinxhirëve të prodhimit dhe të furnizimit, duke përfshirë dhe humbjet pas korrijeve.</p> <p>12.4 Deri në vitin 2020, të arrihet menaxhimi i shëndetshëm mjedisor i kimikateve dhe i të gjitha mbetjeve gjatë ciklit të tyre të jetës, në përputhje me kornizat kuadër ndërkombëtare të miratuara, dhe të zvogëlohet ndjeshëm shkarkimi i tyre në ajër, ujë dhe tokë, me qëllim zvogëlimin e ndikimeve negative mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin.</p> <p>12.5 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm krijimi i mbetjeve përmes zbatimit të parimeve të parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe të ripërdorimit.</p> <p>12.6 Të nxiten kompanitë, veçanërisht kompanitë e mëdha ndërkombëtare, të zbatojnë praktika të qëndrueshme dhe të përfshijnë informacion të qëndrueshëm në ciklin e tyre të raportimit.</p> <p>12.7 Të përkrahen praktika të prokurimit publik që janë të qëndrueshme, në përputhje me politikat dhe prioritetet kombëtare.</p> <p>12.8 Deri në vitin 2030, të sigurohet që njerëzit të marrin informacionin e duhur dhe të ndërgjegjësohen për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës në harmoni me natyrën.</p> <p>12.b Të zhvillohen dhe të zbatohen mjetet për të monitoruar ndikimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm për turizëm të qëndrueshëm, duke krijuar vende pune dhe përkrahur kulturën dhe prodhimet vendase.</p>	


Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Aplikimi i masave më të qëndrueshme në ndërtim. Përdorimi i materialeve qarkore dhe pa toksika, dhe parandalimi i hudhjes së mbeturinave ndërtimore dhe industriale gjatë projekteve ndërtimore.
2. Bashkëpunimi ndërkomunal e rajonal për ekonomi qarkore. Komunat të vendosin bashkëpunim me komunat tjera brenda dhe jashtë vendit për të shikuar mundësitë e dërgimit dhe/ose marrjes së materialeve të cilat janë të riciklueshme.
3. Masat anti-dumping. Të ndërmerren masa ndaj hedhjes së mbeturinave kimike si dhe parandalimin e shpërndarjes së dheut të kontaminuar.
4. Parandalimi i hudhjes së ushqimit të mbetur. Të vendoset bashkëpunimi me gastronomi për të shpërndarë ushqimin e mbetur. Po ashtu, të shikohet mundësia e kompostimit të ushqimit si fertilizues.
5. Ngritja e vetëdijës. Ndërmarrja e aktiviteteve edukative dhe ndërgjegjësuere për modelet e qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit.

	Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre
<p>13.1 Të forcohen aftësitë ripërtëritëse dhe përshtatëse ndaj rreziqeve që lidhen me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet.</p> <p>13.3 Të përmirësohet edukimi, rritja e ndërgjegjësimit dhe e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale lidhur me zbutjen e ndryshimeve klimatike, përshtatjen ndaj tyre, zvogëlimin e ndikimeve dhe paralajmërimin e hershëm.</p> <p>13.b Të përkrahen mekanizmat për ngritjen e kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim efektiv lidhur me ndryshimet klimatike në vendet më pak të zhvilluara dhe në shtetet-ishuj të vegjël në zhvillim, përfshirë dhe fokusimin tek gratë, të rinjve dhe komunitetet vendore dhe të marginalizuara.</p>	


Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Përfshirja e objektivave kundër ndryshimeve klimatike në të gjitha programet dhe buxhetet e komunës.
2. Pyllëzimi. Ruaja e pyjeve nga prerjet e pakontrolluara dhe mbjellja e drunjëve të ri.
3. Parandalimi i ndërtimit në zona të përmybtjes. Ndalimi i ndërtimeve në zona që kanë potencial të përmybtjeve. Po ashtu, të shikohet mundësia e zhvendosjes së zonave të banimit dhe biznesit larg zonave të tilla të përmybtjes që shkakton dëme financiare dhe materiale.
4. Gjelbrimi i zonave urbane. Krijimi i sa më shumë parqeve, kulmeve të gjelbërta dhe format tjera të rritjes së gjelbrimit në zonat urbane.
5. Rritja e vetëdijes dhe edukimi i qytetarëve për të parandaluar veprimet të cilat përshpejtojnë ndryshimet klimatike.

	<p>Mbrojtja, rehabilitimi dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër shkretëtirëzimit, ndalimi e kthimi mbrapa i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit</p>
<p>15.1 Deri në vitin 2020, të sigurohet ruajtja, restaurimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore dhe i ekosistemeve të ujërave të ëmbla dhe shërbimet e tyre, veçanërisht pyjet, ligatinat, malet dhe tokat e thata, në përputhje me detyrimet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.</p> <p>15.2 Deri në vitin 2020, të promovohet zbatimi i menaxhimit të qëndrueshëm i të gjitha llojeve të pyjeve, ndalimi i shpyllëzimit, rehabilitimi i pyjeve të degraduar dhe rritja e qëndrueshme e pyllëzimit dhe ripyllëzimi në nivel global.</p> <p>15.3 Deri në vitin 2030, të luftohet shkretëtirëzimi, rehabilitimi i tokës së degraduar, përfshirë dhe tokën e prekur nga shkretëtirëzimi, thatësira dhe përmbytjet, dhe të synohet ndalimi i degradimit të tokës.</p> <p>15.5 Të ndërmerren masa urgjente dhe të rëndësishme për të zvogëluar degradimin e habitateve natyrore, ndalimin e humbjes së biodiversitetit dhe, deri në vitin 2020, të mbrohet dhe të parandalohet zhdukja e llojeve të kërcënuar.</p> <p>15.9 Deri në vitin 2020, të përfshihen vlerat e ekosistemit dhe të biodiversitetit në planifikimin kombëtar dhe vendor, në proceset e zhvillimit, në strategjitë dhe raportimet për uljen e varfërisë.</p> <p>15.a Të aktivizohen dhe të rriten në mënyrë të konsiderueshme fondet financiare nga të gjithë burimet për të ruajtur dhe për të përdorur në mënyrë të qëndrueshme biodiversitetin dhe ekosistemet.</p> <p>15.b Të aktivizohen fonde të rëndësishme nga të gjitha burimet dhe në të gjitha nivelet për të financuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe për të ofruar stimujt e përshtatshëm për vendet në zhvillim për të ecur përpara në menaxhim, përfshirë dhe ruajtjen e ripyllëzimin.</p>	


Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Përfshirja e masave për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në të gjitha strategjitë dhe planet komunale. Kjo masë siguron që të mos miratohen rregullore apo politika komunale të cilat janë të pandjeshme ndaj mjedisit.
2. Mbrojtja e florës dhe faunës. Të ndërmerren masat për të ruajtur florën dhe faunën brenda secilës komunë, posaçërisht në rastet kur kemi të bëjmë florë dhe faunë të rrallë, apo specifike për vendin, apo edhe me speciet në zhdukje.
3. Ruajtja e përmbajtjes organike në dhe. Të merren masa për të siguruar që të ruhet përmbajtja organike e dheut, posaçërisht në toka bujqësore. Në lokacionet ku rënie të kësaj përmbajtjeje të bëhet trajtimi adekuat për të kthyer nivelin e kënaqshëm të përmbajtjes organike.
4. Planifikimi i mirëfilltë për ruajtje të natyrës. Projektet zhvillimore dhe të mirëmbajtjes duhet të kenë parasysh ruajtjen e vlerave natyrore. Gjithashtu, të caktohen zona të veçanta për zhvillim të natyrës.
5. Bujqësia organike dhe qarkore. Të bëhet promovimi i kultivimit organik të produkteve bujqësore dhe të bujqësisë qarkore.

	<p>Promovimi i shoqërive në paqe dhe gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm, siguria e qasjes në drejtësi për të gjithë, dhe ndërtimi i institucioneve gjithëpërfshirëse, llogaridhënëse dhe efektive në të gjitha nivelet</p>
<p>16.1 Kudo të zvogëlohen ndjeshëm të gjitha format e dhunës dhe numri i vdekjeve si rezultat i dhunës.</p> <p>16.2 T'i jepet fund abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe të torturës ndaj fëmijëve.</p> <p>16.5 Të zvogëlohet ndjeshëm korrupsioni dhe rryshfeti në të gjitha format e tyre.</p> <p>16.7 Të sigurohet vendimmarrje e përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet.</p> <p>16.9 Deri në vitin 2030, të sigurohet identiteti ligjor për të gjithë njerëzit, duke përfshirë regjistrimin e lindjes.</p> <p>16.10 Të sigurohet e drejta e publikut për të marrë informacion dhe të mbrohen liritë themelore të njeriut, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.</p> <p>16.a Të fuqizohen institucionet përkatëse kombëtare, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, për ngritjen e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.</p>	

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:

1. Komuna me integritet. T'i kushtohet rëndësi integritet komunal përmes masave dhe sanksioneve të rrepta ndaj korrupsionit dhe konfliktit të interesit.
2. Transparenca komunale. Komunat të bëjnë publike të gjitha dokumentet relevante të lejuara për publikim me ligj, dhe të ofrojnë përgjigje të shpejta ndaj kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare. Në veçanti, duhet të ketë transparencë në punësim, ndarje dhe ekzekutim të buxhetit.
3. Mekanizma efektiv për raportim të dhunës. Komunat të miratojnë procedura dhe task force bashke me akterët përkatës për të reaguar shpejt ndaj raportimeve të dhunës në familje dhe formave tjera të dhunës. Gjithashtu, duhet të ketë bashkëpunim me organizata përkatëse për ofrimin e kujdesit për viktimat.
4. Bashkëpunimi me organe të rendit. Qytetarët të edukohen për të raportuar rastet e krimit. Po ashtu, komunat të kenë bashkëpunim efikas me organet e rendit dhe të ligjit për të adresuar rastet e krimit dhe korrupsionit në komunat përkatëse.
5. Ndriqim i rrugëve për të rritur sigurinë e vajzave dhe djemëve. Kjo masë do të rriste sigurinë posaçërisht në muajt e dimrit kur kemi errësim të hershëm. Në veçanti të ndriqohen rrugët përreth shkollave drejt lagjeve përkatëse.

	<p>Fuqizimi i mjeteve të zbatimit dhe të rigjallërimit të partneritetit global për një zhvillim të qëndrueshëm</p>
<p>17.1 Të forcohet aktivizimi i burimeve të brendshme, përfshirë edhe përmes mbështetjes ndërkombëtare për vendet në zhvillim, për të përmirësuar kapacitetin e brendshëm për mbledhjen e taksave dhe të të ardhurave të tjera.</p> <p>17.14 Të rritet bashkëpunimi politik për Zhvillimin e Qëndrueshëm.</p>	

17.16 Të rritet partneriteti global për Zhvillimin e Qëndrueshëm, plotësuar nga një partneritet shumëpalësh që aktivizon dhe shkëmben njohuri, ekspertizë, teknologji dhe burime financiare, për të mbështetur arritjen e objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në të gjitha vendet, e në veçanti në vendet në zhvillim.

17.17 Të nxitet dhe të përkrahet partneriteti publik efektiv, partneriteti publik-privat dhe partneriteti i shoqërisë civile, i ngritur mbi përvojën, burimet dhe strategjitë e partneritetit.

17.19 Deri në vitin 2030, të ngrihet mbi nismat ekzistuese për të zhvilluar masa të progresit për Zhvillimin e Qëndrueshëm që plotësojnë prodhimin e brendshëm bruto dhe mbështetin ngritjen e kapaciteteve statistikore në vendet në zhvillim.

Shembuj të përmbushjes së këtyre Synimeve nga komunat përfshijnë:


1. Qeverisje gjithpërfshirëse. Ndërmarrja e masave për të përfshirë qytetarët në vendimmarrje, në veçanti, rininë, grupet e cenuara e të moshuarit.
2. Menaxhim efektiv. Të sigurohet menaxhim dhe koordinim efektiv ndërmjet organeve komunale. Të ketë qartësi në ndarje të detyrave dhe përgjegjësi dhe lidhje të qarta me qëllimet e udhëheqjes komunale.
3. Fushata të vazhdueshme informuese. Qytetarët duhet të informohen me kohë për të gjitha veprimet dhe vendimet që i ndërmerr komuna, pasi që janë drejtpërsëdrejti të prekur nga ato veprime dhe vendime. Prandaj, duhet të përdoren të gjitha kanalet e komunikimit për të dërguar informatat të sakta dhe të qarta te qytetarët.
4. Pjesëmarrje në buxhet. Të mbahen konsultime të rregullta me qytetarë të të siguar që prioritetet e tyre të përfshihen në buxhetin komunal.
5. Bashkëpunimi. Komunat duhet të aplikojnë një qasje konstruktive bashkëpunimi me të gjitha komunat tjera, nivelin qendror si dhe në rajon dhe gjerësisht në botë.












Korniza legjislative dhe e politikave

Kosova ka një sistem të qeverisjes lokale të decentralizuar duke i dhënë kompetenca të konsiderueshme në qeverisje për nivelin lokal. Kjo kornizë legjislative e decentralizuar e bën rolin e komunave të Republikës së Kosovës edhe më të madh në integrimin dhe përmbushjen e OZHQ-ve dhe Agjendës 2030.

Dokumenti kryesor legjislativ që rregullon kompetencave e pushtetit lokal në Kosovë është Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Në veçanti është nen 17 i këtij ligji që bën zbërthimin e kompetencave të pushtetit lokal.

Më poshtë është dhënë një tabelë që tregon ndërlidhjen e kompetencave kryesore të komunave të Republikës së Kosovës dhe OZHQ-ve.

Kompetenca komunale	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
Zhvillimi lokal ekonomik	
Planifikimi urban dhe rural	
Shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimi	

	
Zbatimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit	
Mbrojtja e mjedisit lokal	
Ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale	
Ofrimi i arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit	
Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut	
Ofrimi i përkujdesit publik primar shëndetësor	
Ofrimi i shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e profesionistëve të mirëqenies sociale	
Banimi publik	
Shëndetësia publike	
Ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirës publike	

Në aspektin e politikave strategjike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka miratuar Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026 e cila parasheh pesë Objektiva Strategjike për komnatat e Republikës së Kosovës.

Këto Objektiva Strategjike mbulojnë në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi OZHQ-të. Pesë Objektivat Strategjike ngërthejnë në vete masa të veprimit të cilat prekin më gjerësisht OZHQ-të. Në tabelën mëposhtë është bërë ndërlidhja e Objektivave Strategjike me OZHQ-të.

Objektiva Strategjike ² të Vetëqeverisjes Lokale	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikat zhvillimore dhe financiare të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal	
Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase komunale	
Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të organeve të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët	
Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive	
Promovimi i vlerave të trashëgimisë dhe diversitetit kulturor, natyror dhe social me qëllim të afirmimit dhe zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor në komuna	

Raportimi

Një segment shumë i rëndësishëm në përmbushjen e OZHQ-ve është raportimi i masave të ndërmarra drejt përmbushjes së tyre. Për një proces të mirëfilltë të raportimit të përmbushjes së OZHQ-ve duhet bërë lokalizimi i indikatorëve për matjen e progresit drejt OZHQ-ve. Në total, Organizata e Kombeve të Bashkuara ka nxjerrë 248 indikatorë, por në fakt janë 231 indikatorë unik pasi 17 prej tyre përsëriten në dy apo më shumë raste. Të dhënat e mbledhura nga këta indikatorë më pas duhet të përbëjnë bazën për hartimin e Shqyrtimit Vullnetar Lokal si mekanizëm për të pasqyruar gjendjen e një komune apo qyteti në relacion me përmbushjen e OZHQ-ve. Këtë vit, për herë të parë në Kosovë një komunë ka iniciuar hartimin e Shqyrtimit Vullnetar Lokal (SHVL).

U theksua më sipër se komunat në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorë përmbushin një numër të OZHQ-ve por kjo kalon e pavërejtur për shkak të mosraportimit të tyre. Prandaj, duhet të instalohet një sistem i raportimit të masave të cilat përmbushin në mënyrë të pjesshme apo të plotë Synimet e OZHQ-ve. Kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të zëvendësojë përpjekjet për të hartuar SHVL-të, por duhet të bëhet një raportim në mënyrë që Kosova të dëshmojë ndërkombëtarisht se është duke punuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm siç bëjnë edhe shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Më poshtë janë dhënë disa shembuj të masave që komunat e Kosovës i zbatojnë rregullisht por nuk raportohen si masa drejt përmbushjes së OZHQ-ve.

- Subvencionet bujqësore drejtpërsëdrejti bëjnë përmbushjen e Synimit 2.3

² Shih në: https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/08/Strategjia_liber_tri-gjuhe_finale-2016.pdf

- Arsimi gjithëpërfshirës dhe masat për adresimin e braktisjes së shkollimit fillor bëjnë përmbushjen e Synimit 4.1.
- Investimet në zgjerim të rrjeteve të ujit të pijshëm bëjnë përmbushjen e Synimit 6.1
- Ndërtimi i shtëpive/banesave për qytetarët në nevojë bën përmbushjen e Synimit 11.1
- Lirimi nga pagesa e transportit publik për pensionerë dhe kategori tjera sociale është masë drejt përmbushjes së Synimit 11.2
- Projektet për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore bëjnë përmbushjen e Synimit 11.4
- Rritja e hapsirave të gjelbëra, mbjellja e fidaneve, dhe të ngjashme bëjnë përmbushjen e Synimit 15.2
- Masat kundër korrupsionit bëjnë përmbushjen e Synimit 16.5
- Të gjitha aktivitetet dhe masat drejt rritjes së transparencës bëjnë përmbushjen e Synimit 16.6

Përfundime

Komunat e Republikës së Kosovës duhet të bëjnë më shumë për të përmbushur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. U nënvizua se komunat janë përgjegjëse për rreth 60% të OZHQ-ve apo 99 Synimeve (nga total 169). Një numër i konsiderueshëm i këtyre Synimeve plotësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, por mungon një proces i koordinuar i përfshirjes dhe raportimit.

Ideale do të ishte që të gjitha komunat në Kosovë të bëjnë lokalizimin e OZHQ-ve dhe të indikatorëve si dhe të hartojnë Shqyrtimin Vullnetar Lokal. Por në bazë të gjendjes aktuale do të ishte ambicioze të pritet lokalizimi dhe raportimi përmes SHVL-së. Prandaj, komunat së paku do të duhej të instalojnë një dinamikë të punës përmes një procesi të përfshirjes dhe raportimit të OZHQ-ve në mënyrën e përshkruar në këtë raport.

Synimet e identifikuar që bien nën përgjegjësi të komunave të Republikës së Kosovës duhet të integrohen në planifikim strategjik dhe punë të përditshme të komunave. Këto Synime mund të shërbejnë edhe si udhërrëfyes për planifikim të projekteve komunale.

Për këtë është i nevojshëm një vetëdijësim dhe trajnim i stafit të drejtorive komunale për të kuptuar rëndësinë e OZHQ-ve si dhe për t'u trajnuar rreth planifikimit të projekteve komunale në përputhje me OZHQ-të dhe Synimet përkatëse. Njëkohësisht duhet ngritur kapacitetet për raportim rreth përmbushjes së OZHQ-ve. Secila drejtori komunale brenda kompetencave përkatëse mund të përmbush Synimet që bien brenda kompetencave të drejtorisë përmes integritit të Synimeve gjatë planifikimit ose zbatimit.

Pra, duhet të instalohet një proces ku drejtoritë komunale në fazën e planifikimit dhe zbatimit të projekteve marrin parasysh OZHQ-të dhe bëjnë krahasimin e projekteve komunale përballë OZHQ-ve dhe Synimeve përkatëse.

Ky proces mund të jetë një fazë tranzicionale drejt lokalizimit të plotë të OZHQ-ve nga komunat e Republikës së Kosovës.

Ky projekt financohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).